

**Iniciativa për dialog strategjik**

**Grupi punues për ekonomi**

*(Mars/Nëntor 2004)*

**Analiza e pjesëve të Mikro dhe Makro**

**Ekonomisë dhe Rekomandime**

**Shkup, 2004**

<b>Hyrje</b> .....	3
<b>Tre prioritete: politika monetare, politika e kursit devizor dhe politika fiskale</b> .....	5
Prioriteti i parë: Politika monetare.....	5
Rekomandime.....	8
Prioriteti i dytë: Kursi devizor.....	8
Rekomandime.....	8
Prioriteti i tretë: Politika fiskale.....	9
Rekomandime.....	14
<b>Ristrukturuimi,revitalizimi dhe modernizimi i ekonomisë së Maqedonisë</b> .....	16
Përshkrimi i status kuosë.....	16
Përshkrimi i popullatës që është e influencuar/e goditur drejtpërdrejtë dhe si ajo është e influencuar/e goditur drejtpërdrejtë.....	17
Analiza.....	18
Rekomandime.....	20
<b>Zhvillimi i sektorit të ndërmarjeve të vogla dhe të mesme në Republikën Maqedonisë</b> .....	23
Përshkrimi gjendjes së status kuosë.....	23
Përshkrimi i popullatës së influencuar.....	25
Analiza.....	26
Rekomandime.....	29
<b>Stërvitje dhe edukim afarist</b> .....	34
Përshkrimi i status kuosë.....	34
Përshkrimi i target popullatës.....	35
Analiza.....	36
Rekomandime.....	37
<b>Lista e pjesëmarrësve të grupit punues të ekonomisë</b> .....	40

## Hyrje

Iniciativa për dijalog strategjik është projekt i Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (QEÇP) në Zyrën Rajonale në Shkup. Në Kuadër të këtij projekti u themeluan katër grupe punuese që diskutuan për problemet që kanë të bëjnë me arsimin, ekonominë, shëndetësinë dhe të drejtat e njeriut. Anëtarët e grupit punues janë përfaqësues nga institucione me ndikues për çdonjërën nga lëmitë. Qëllimi parësor i këtyre grupeve punuese është që ti identifikojnë problemet dhe të përpilojnë rekomandime që do tu ndihmojnë atyre që sjellin vendime, të formulojnë dhe implementojnë politikë të drejtë dhe gjithpërfshirëse e cila do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, do ta forcojë sundimin e të drejtës dhe do të mundësojë kushte më të mira ekonomike për të gjithë popujt që jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi sekondar është përforcimi dhe vendosja e marrëdhënieve punuese midis pjesëtarëve të segmeneteve të ndryshme të shoqërisë.

Çdonjëri nga grupet punuese numëron prej 10 deri 15 ekspertë nga tre profilë të ndryshme profesionale: politikanë dhe anëtarë të qeverisë, profesorë univerzitar, profesionistë dhe ekspertë të lëmive relevante si dhe liderë dhe aktivistë të Organizatave joqeveritare (OJQ-ve). Anëtarët e grupeve punuese u takojnë të gjitha grupeve etnike dhe fetare në Maqedoni dhe shumica e tyre janë nga Shkupi, ndërsa anëtarët tjerë vijnë nga Tetova, Gostivari, Manastiri, Shtipi dhe Kumanova.

Çdonjëri nga grupet punuese takohet çdo javë të tretë ose të katërt të muajit dhe puna e tyre zhvillohet përmes një vargu hapash të planifikuara për identifikimin, definimin dhe dhënien përparësi të lëmive kryesore që shkaktojnë probleme, e të cilat janë në kuadër të punës së tyre, grumbullimit të informacioneve plotësuese për problemet prioritare, analizës së informacioneve, përgatitjes së rekomandimeve dhe zhvillimit të strategjisë për prezentimin e të njejtave.

Kah fundi i vitit, çdo grup punues do të mbajë konferencë për mediat, në të cilën do të prezentojë rezultatet dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me problemet. Menjëherë pas kësaj do të organizohen takime bilaterale midis përfaqësuesve të grupeve punuese dhe personaliteteve relevante të institucioneve dhe organizatave që janë emërtuar në rekomandimet.

Me planifikimin e kohës për punë me institucionet dhe organizatat që kishin mandat për implementimin e reformave do ta shtojmë gjasën që rekomandimet të jenë të kuptuara dhe të përkrahen.

Grupi punues për ekonomi ndau energjinë e tij që të përfshijë makroekonominë, si dhe mikroekonominë. Përmes disa mbledhjeve të ndara sipas strukturës dhe temave, anëtarët e grupit identifikuan dhe analizuan katër probleme të rëndësishme:

- I. Politika monetare, politika e kursit devizor dhe politika fiskale
- II. Ndryshimet strukturore në ekonominë e Maqedonisë
- III. Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- IV. Trajnime për biznes dhe edukim

Në këtë dokument mund t'i gjeni të elaboruara në detaje problemet e lartpërmendura, si dhe rekomandimet se si ato mund të tejkalohen.

Ky dokument i është dërguar Ministrisë së ekonomisë, Institutit ekonomik, Ministrisë së finansave dhe Bankës Popullore.

Nëse dëshironi të merrni më tepër informacione për organizatën tonë, si dhe për projektet që i realizojmë, Ju ftojmë që ta vizitoni faqen tonë të internetit [www.ecmipolicydialogue.org.mk](http://www.ecmipolicydialogue.org.mk) ose [www.ecmimacedonia.org.mk](http://www.ecmimacedonia.org.mk) ose të na kontaktoni çdo ditë pune prej orës 09:00-17:00.

Me shpresë se do të kemi bashkëpunim në të ardhmen,

**Michael Szporluk**  
Këshilltar politik

## **Tre prioritete: Politika Monetare, Politika e kursit devizor dhe Politika fiskale**

### **Prioriteti i parë: Politika monetare**

Republika e Maqedonisë me sukses realizoi programin stabilizues me politikë restriktive monetare, i cili rezultoi me stabilitetin e çmimeve dhe konsolidimin makroekonomik. Por, sukse si modelit të një politike stabilizuese makroekonomike nuk guxon të vlerësohet vetëm përmes realizimit të stabilizimit, por duhet të krijojë, të kontrollojë dhe ta ruajë ambientin e fuqishëm makroekonomik, pa krijimin e gjendjes së stagnimit ose të shkallëve të ulta të rritjes ekonomike. Kështu, programi stabilizues patjetër duhet të mundësojë shkallë më të lartë të rritjes ekonomike dhe zvogëlimin konstant të shkallës së papunësisë, e cila për fat të keq në RM është në nivelin prej 32,1%.

Duke pasur parasysh BPV për një banor në ekonomitë e vendeve në tranzicion, ata mund të jenë të ballafaquar me krizë ekonomike, politike, si dhe sociale nëse ekziston gjendja e vazhdueshme e rritjes së ulët ekonomike. Kështu ndodhi në Argjentinë, Brazil dhe në disa vende tjera në tranzicion. Disa shtete Aziatike dolën nga kriza ekonomike përmes shkallës vjetore të rritjes prej 8% deri më 10 %. Domethënë, stabilizimi makroekonomik duhet në mënyre efikase të menaxhojë me kërkesën agregate (përmes masave të politikës monetare dhe fiskale) e nga ana tjetër të shfrytëzojë instrumente të caktuara nga oferta në ekonomi.

Qytetarët nuk përkrahin një politikë makroekonomike në një afat më të gjatë, nëse ajo nuk krijon mundësi për punësim. Stabilizimi është i rëndësishëm vetëm nëse e mundëson zhvillimin dhe krijimin e mundësive të reja.

Si indikator i standardit, Republikës së Maqedonisë do ti nevojitet shkallë mesatare e rritjes industriale nëse dëshiron ta arrijë nivelin e zhvillimit të një Austrije.

Republika e Maqedonisë arriti të krijojë stabilitet makroekonomik me përdorimin e kursit devizor si spirancë nominale, por në llogari të rritjes ekonomike. Kjo politikë për një afat të gjatë është e paqëndrueshme. Politika e këtillë restriktive monetare, e cila është vetëm në funksion të stabilitetit të çmimeve, sipas mendimit tonë dëmton sektorin real. Një numër i madh i studimeve të rëndësishme tregojnë se përdorimi i vazhduar i politikës të tepruar monetare restriktive, përkatësisht lidhja e valutës vendase me ndonjë valutë të fuqishme, frenon zhvillimin ekonomik.

## **Rekomandime**

Politika monetare në një afat të mesëm duhet të lëviz në drejtimet vijuese:

- Zhvillimi i shpejtë i instrumenteve të tërthorta të tregut, mekanizmave dhe institucioneve të tregut të parave dhe të kapitalit përmes valutës stabile dhe finansave; por pa politikën restriktive si mjet për realizimin e valutës stabile vendore,
- Braktisja e targetit kuazioperativ i parave primare nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në rregullimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe mbajtja e tij në nivelin optimal, përmes botimit të fletëobligimeve. E tërë kjo ndikon negativisht mbi funksionimin efikas të tregut të parave dhe të investimeve, si rezultat i asaj që u theksua paraprakisht.
- Aplikimi i shkallëzuar i shkallëve afatshkurtëra të kamatave si target operativ, përmes vendosjes së instrumenteve të rregullta për rregullim monetar (rezerva e obligueshme, operacione në tregun e hapur e tjera), për pjesëmarrjen e të gjitha faktorëve në tregun e hapur, gjë e cila do të krijojë shkallë vetanake të kamatave në tregun e kapitalit dhe do të çojë kah kjo:
  - a) likuiditeti optimal,
  - b) niveli optimal dhe stabil i shkallëve afatshkurtëra të kamatave nga aspekti i efektit të tyre mbi shkallët afatgjata të kamatave, e me këtë edhe mbi qëllimin përfundimtar të politikës monetare;
- aplikimi i shkallës afatshkurtër si target operativ do të kontribuojë për rindarje të likuiditetit të bankave dhe formimin e shkallëve të kamatave përmes tregut, në pajtim me lëvizjen e ofertës dhe kërkesës së mjeteve likuide, e me këtë do të eliminohet ndërmjetësimi i drejtpërdrejtë i

Bankës Popullore të Maqedonisë (BPM) në tregun e parave në drejtim të ofertës dhe kërkesës së mjeteve likuide;

- liberalizimi i transakcioneve kapitale është imperativ i zhvillimit të tregut të parave në kuptimin e vërtetë të fjalës;
- Për shkak të braktisjes së parave primare si target operativ dhe aplikimit të shkallëve afatshkurtëra të kamatave, nevojitet braktisja e strategjisë së targetimit me kursin devizor si spirancë nominale dhe restriksioneve të vendosura të transfereve kapitale. Në kushte të këtilla shkallët e kamatave në tregun e parave paraqiten si absorbues të lëkundjeve në tregun devizor;
- Pas reformave të realizuara intenzive gjatë dy viteve të fundit në sektorin financiar ambienti në të cilin vepron politika monetare është i ndryshuar tërësisht, por vetë politika monetare ka mbetur e pandryshuar. Para do kohësh u bë vërejtja se politika monetare është tejet rigjide, nuk ofron hapësirë për zvogëlimin e shkallëve të kamatave të bankave komerciale dhe paraqet frenë për zhvillimin ekonomik të vendit;
- Por, edhe përkundër rezistencës së bankës qendrore, se është herët për braktisjen e kursit devizor si spirancë nominale, prapseprap duhet të lejohet regjimi i kursit fluktues të menaxhuar të denarit me paritet bazik dhe me margjina të përcaktuara. E tërë kjo do ta zvogëlojë nevojën për intervenimet e bankës Qendrore mbi shkallët e kamatave në tregun e parave, me qëllim që ta mbrojë, me çdo kusht, kursin devizor si spirancë nominale.

### Prioriteti i dytë:Kursi devizor

Me lidhjen e valutës vendase si spirancë nominale me ndonjë valutë të fuqishme, Qeveria tregon se është serioze në përpjekjet që ta zvogëlojë inflacionin. Përvojat tregojnë se kjo spirancë nuk mund të qëndrojë nëse nuk mbështetet në një varg konzistent të masave përkatëse të politikës makroekonomike, para së gjithash të politikës fiskale dhe monetare.

Disa ekspertë, siç janë **Hamann J., IMF Staff Papers, (2001), Fatas A. dhe Rose K., IMF (2001), Levy-Yeyati, IMF (2001)** e kritikojnë mbajtjen e stabilitetit të çmimeve në një afat të gjatë, për shkak se këto masa rrisin shkallët e kamatave dhe krijojnë kontraksion monetar në llogari të zvogëlimit të rritjes ekonomike, me ç'rast ekziston rreziku potencial për kolaps ekonomik të vendit, (posaçërisht tek vendet që kanë rënie të eksportit dhe rritje të importit, gjë e cila është karakteristike për Republikën e Maqedonisë).

Gjithashtu në **IMF Annual Research Conference në vitin 2001** është treguar se performancat ekonomike tek disa vende Aziatike tregojnë rritje të ngadalësuar ekonomike. Pas krizës valutore aziatike iu qas analizës së depresimit me aplikimin e modelit standard monetar me rritjen e shkallëve të kamatave dhe restriksionin monetar, me qëllim që të mbrohet kursi devizor. Mirëpo, edhe përkundër pritjeve që kursi të arrijë apresiacion, ai edhe më tej vazhdoi të përjetojë depresiacion, kështuqë në qarqet shkencore u krijua dyshimi për efikasitetin e modelit të këtillë.

#### Rekomandime

- Braktisje e regjimit të tanishëm për kursin devizor si spirancë nominale. Përderisa nga njëra anë kjo sjell një inflacion të caktuar për një afat të mesëm, e njejta do ta arrijë qëllimin përfundimtar, përkatësisht stabilitetin makroekonomik me rritje më të madhe.
- Para se të ndërpritet politika e tillë, duhet të bëhet një studim me parametra kuantitative. Si shtesë për këtë nevojitet një studim më gjithëpërfshirës duke pasur parasysh vështirësinë e operacioneve të këtilla. Këto studime do të tregojnë se në çfarë kushtesh Maqedonia duhet të ndërmer masa të këtilla.

### Prioriteti i tretë: Politika fiskale

Republika e Maqedonisë shpalli pavarësinë e saj monetare dhe fiskale në kushte të hiperinflacionit. Në vitin 1993 të dalat publike arritën nivelin më të lartë prej 53,6% të BPV, ndërsa deficitin fiskal ishte 12,5% të BPV-së. Politika tatimore ishte e bazuar në njëfarë modeli të plotë, racional, konzistent dhe koherentt, përkatësisht ekzistonte mungesë e barazpeshës në strukturën e llojeve të tatimeve.

Në këtë periudhë monetizimi i deficitit të sektorit publik trajtohej si gjenerator themelor i hiperinflacionit. Prandaj, Qeveria në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar iu qas përgatitjes së programit stabilizues me masa restriktive të politikës monetare dhe fiskale.

Në kuadër të programit stabilizues ishin paraparë masa reformuese, si në sferën monetare, ashtu edhe në sferën fiskale.

Masat reformuese në sferën fiskale ishin të synuara kah:

- zvogëlimi i shpenzimeve publike nën nivelin prej 35%, zvogëlimi i deficitit fiskal nën nivelin prej 3% dhe të borxhit publik nën nivelin prej 60% prej BPV-së; dhe
- sjellja e sistemit të ri tatimor në Republikën e Maqedonisë.

Për fat të keq, në këtë periudhë nuk u aplikua tatimi mbi vlerën shtesë.

Të gjitha këto tregues në kuadër të programit stabilizues mund të konsiderohen si vlera referuese të kriterëve në pajtim me marrëveshjen e Mاستrihtit për krijimin e Unionit Evropian monetar (dhe ekonomik) –EMU (European Monetary Union-EMU). Në tabelën vijuese janë shfaqur shpenzimet dhe të hyrat publike në periudhën prej vitit 1994 deri në vitin 2001.

**Tabela 1: Sektori publik në Republikën e Maqedonisë**  
si pjesë përbërëse e BPV

Viti	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Gjithsejt të hyra	43,1	37,9	35,7	34,8	33,3	35,4	36,6	34,1
Gjithsejt shpenzime	45,8	39,0	36,3	35,5	35,0	35,2	34,1	40,3
Deficiti/suficiti (%)	-2,7	-1,0	-0,6	-0,8	-1,7	0,2	2,5	-6,2

Burimi: Ministria e finansave

Në periudhën prej vitit 1994 deri në vitin 2001 Pushteti fiskal ishte i fokusuar në të dalat publike, si dhe në të hyrat publike. Shpenzimet publike u zvogëluan dukshëm prej 45,8% të BPV, në 34,1% në vitin 2000 ( duke e përjashtuar vitin 2001 si aberacion që kishte të bëjë me konfliktin e armatosurt në vend), që paraqiste një

përparim të madh në pikpamaje të zvogëlimit të shpenzimit buxhetor në raport me bruto-prodhimin vendor.

Gjithashtu, nga Tabela 1 mund të shihet se Republika e Maqedonisë në tërë këtë periudhë ka arritur zvogëlimin e deficitit buxhetor në raport me bruto-prodhimin vendas, gjë e cila është në pajtim me kriterin e marrëveshjes së Mastroihtit, që është parakusht për hyrje të vendit në Unionin Evropian. Në krahasim me vendet tjera në tranzicion, Republika e Maqedonisë në vitin 2000 kishte njërin nga nivelet më të ulta të shpenzimit buxhetor në krahasim me BPV, me ç'rast në të njëjtën periudhë është 34,1% (në Kroaci ishte 47,3%, në Slloveni 44,1%, Sllovakia 45,4%, Bullgari 44,4%, Poloni 42,6%, Hungari 45,1% e kështu me radhë).

Në kuadër të shpenzimit buxhetor pjesë dominante kanë shpenzimet jodiskrecionale, që arrijnë rreth 80%, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga shpenzime diskrecionale dhe transfere kapitale. Vetëm të dalat rrjedhëse arrijnë 89% nga shpenzimet jodiskrecionale, prej të cilave 40% janë transfere rrjedhëse, 39% janë rrogat dhe qiratë, 12% janë shpenzime për mallra dhe shërbime dhe 9% janë shpenzime për pagesa të kamatave. Rrogat dhe qiratë, janë zë kryesor në buxhetin qendror (30% si rezultat numrit të trashëguar të tepërt të të punësuarve në administratën publike). Pjesëmarrja e këtij zëri është njëra prej më të mëdhejve në krahasim me vendet tjera. Numri i tërësishëm i shfrytëzuesve buxhetor në Qeverinë dhe në administratën publike është rreth 68.000 sosh, gjë e cila paraqet shifër tejet e lartë në krahasim me vendet tjera në tranzicion. Të gjithë faktorët e lartpërmendur bënë që Qeveria me Bankën Botërore, të përgatisë strategjinë për reformën e administratës publike, me qëllim që të krijojë bazë reale për zvogëlimin e shpenzimeve dhe për ndryshimin e strukturës së pavalitshme të buxhetit. Për një periudhë afatmesme, ndarja e aktiviteteve joqenësore duhej të krijonte bazë reale për korrigjimin e masës së rrogave, si një ndër parakushtet e rëndësishme për krijimin e administratës profesionale dhe efikase.

Ekonomia kalon nëpër ndryshime të thella strukturore, që rezultojnë me rënien e prodhimitarisë, rënien e shpenzimeve vendase dhe rritjen e shkallës së papunësisë, e prej aty del edhe rritja e transfereve rrjedhëse (40%). Kjo dukuri e pjesëmarrjes dominante e transfereve rrjedhëse është dukuri e shpeshtë në pothuajse të gjitha vendet në tranzicion, gjë e cila është rezultat i reformave strukturore.

Duke analizuar vit pas viti transferet rrjedhëse si shpenzime jodiskrecionale janë 7.5% të BPV-së, prej të cilave Fondit për sigurim pensional dhe invalidor i takon 30.18%, Entit për punësim 20,7%, programeve sociale 18,4% e mandej vijojnë reforma e administratës publike, reformat strukturore e tjera.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime mesatarisht janë 12% nga Buxheti, gjë e cila është ngjashëm me mesataren e vendeve tjera në tranzicion. Duke e pasur parasysh

lëvizjen e këtij zëri në ekonomi të ndryshme në tranzicion (te Republika Çeke 6%, te Sllovakia 10,4%, Kroacia 22,4%, Sllovenia 17,62%, e kështu me rradhë), mund të konkludohet se këto shpenzime janë pengesë kryesore për konsolidimin fiskal të anës së shpenzimeve të Buxhetit.

Pagesat për kamatat janë 6,4% të Buxhetit dhe 1,7% nga BPV, gjë e cila tregon ngarkimin mesatar të Buxhetit. Ky zë është në kuadër të mesatares së vendeve në tranzicion.

Shpenzimet kapitale si komponentë zhvillimore në kuadër të shpenzimit buxhetor paraqesin komponentë të rëndësishme të rritjes afatgjate ekonomike, për shkak se mjetet finansiare futen në investime të reja publike, në rikonstruimin e objekteve ekzistuese kapitale dhe në modernizimin e pajisjes. Edhe përkundër rëndësisë së tij, ky zë në periudhën e kaluar ishte tejte i ulët (1,9%), që ishte si një frenë e zhvillimit.

Mund të dallohen tre periudha finansiare të anës së të hyrave të Buxhetit.

1. ...1993: ekzistonte sistem jokonzistent tatimor, që mekanikisht i ndërlihte llojet e ndryshme të të hyrave, përkatësisht një tog tatimesh që aplikoheshin dhe juridikisht rregulloheshin në mënyrë autonome, në nivel republikan dhe lokal. Kombinimi dhe struktura e këtillë e tatimeve dhe të hyrave tjera publike nuk mund të realizojë politikë efikase tatimore, siç ndodh në shtetet e zhvilluara.
2. 1994-2000: reforma radikale në sferën fiskale, sjellja e ligjit për tatimin personal, Ligji për tatim në fitim, Ligji për tatimin e konsumit, Ligji për akcizat dhe ligje të tjera (por jo edhe Ligji për tatimin mbi vlerën shtesë). Struktura tatimore dhe përcaktimi i llojeve kryesore të tatimeve mbështetej mbi modelet dominuese dhe mbi strukturat e sistemeve tatimore në ekonomitë e zhvilluara me orientim tregu dhe ajo përfshin si vijon:
  - braktisja e të gjitha elementeve në sistemin tatimor që fusin distorzione në mekanizmat e tregut dhe në alokimin e resurseve;
  - zgjerimi i obligimit tatimor dhe aplikimi i shkallëve më të ulta të tatimeve (shkalla e përgjithshme e tatimit të konsumit u zvogëlua prej 42% në 25%), si dhe kufizimi i stimulimeve fiskale, lirimeve dhe arritja e neutralitetit alokativ të sistemit tatimor;

- aplikimi i parimeve të barazisë horizontale dhe vertikale në procedurat tatimore dhe arritja e efekteve të nevojshme redistributive në kuadër të funksionit socialo-politik të sistemit tatimor;
- aplikimi efikas i funksionit primar fiskal, në kushte të nivelit optimal të ngarkesës fiskale; dhe
- realizimi i suksesshëm i rolit të sistemit tatimor në kuadër të politikës ekonomike në lidhje me korigjimin e lëvizjeve konjunkturale.

Këto reforma themelore kontribuan për aplikimin e sistemit të ri tatimor i cili është i ngjashëm me sistemin tatimor e vendeve të zhvilluara. Duke pasur parasysh të hyrat buxhetore dhe trendet në anën e shpenzimeve në gjashtë vitet e ardhshme, mund të vlerësohet se këto ndryshime në legjislativën u implementuan me sukses.

3. 2000-... :ka të bëjë me aplikimin e tatimit të vlerës shtesë, i cili u soll si rezultat i aplikimit të këtij tatimi në vendet e Bashkimit Evropian, si dhe lidhshmëria ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë dhe si rezultat i respektimit të parimit të karakterit neutral të tatimeve. Me këtë rast, intenca ishte që të zvogëlohet roli i tatimeve në të hyrat (kursimet dhe investimet) dhe nevoja për rritjen e rolit të këtij lloji të tatimit, me çka do të krijohen parakushtet për kycjen e ardhshme të vendit në Unionin Evropian. Vlerësohej se ky do të jetë hapi i parë kah modernizimi dhe harmonizimi i strukturës tatimore. Ligji de fakto ishte në tërësi i harmonizuar me Direktivën e Gjashtë për tatimin mbi vlerën shtesë të Unionit Evropian. Ky tatim aplikohet me dy shkallë: shkallë e përgjithshme tatimore prej 18% dhe shkallë e privilegjuar tatimore prej 5%. (Ekzistojnë edhe prodhime edhe shërbime që janë të liruara nga tatimi mbi vlerën shtesë).

Nëse krahasohet struktura e të hyrave tatimore para aplikimit të tatimit mbi vlerën shtesë dhe pas implementimit të tij, do të shihet se të hyrat në sajë të këtij tatimi janë shtuar, ndërsa të hyrat nga tatimet tjera janë zvogëluar, kështu që në vitin 1999, struktura e të hyrave tatimore ishte si vijon: tatimi mbi qarkullimin 23,8%, dogana 19,8%, tatimi personal 24,5%, tatimi mbi fitimin 6,1%, dhe tatimet tjera 0,3%, ndërsa në vitin 2000, pas aplikimit të tatimit mbi vlerën shtesë, struktura e të hyrave publike ndryshoi në mënyrë drastike dhe atë: tatimi mbi vlerën shtesë 34,1%, doganat 15,1%, tatimi personal mbi të ardhurat 21,1%, tatimi mbi fitimin 5,5% dhe tatimet tjera 0,1%. Në strukturën tatimore vërehet tendenca për

zhvendosjen e qendrës nga tatimet e drejtpërdrejta mbi të hyrat, në drejtim të tatimeve mbi konsumin, por jo përmes diferencimit të shkallëve, por me zgjerimin e përfshirjes së prodhimeve dhe të përfshirjes së prodhimeve dhe shërbimeve që janë lëndë e tatimit, me braktisjen e shmangjeve dhe lirimit nga tatimi. Bëhet fjalë për ridistribucionin e karakterit fiskal, nga tatimet e drejtpërdrejta në drejtim të tatimeve të tërthorta, gjë e cila ishte posaçërisht e theksuar para aplikimit të tatimit mbi vlerën shtesë. Si rezultat i kësaj që u tha më lartë, pas suficitit të realizuar buxhetor prej 2,5% në vitin 2000, Qeveria i zvogëloi shkallët progresive të tatimit personal prej 23%, 27% dhe 35% në 15% dhe 18%, që janë midis më të ultave në Evropë.

Kjo nevojë për reforma tatimore mbështetet mbi njohjen e Teorisë bashkëkohore të ekonomisë së ofertës (Supply Side Economics), e cila thekson nevojën e neutralitetit më të madh ekonomik të tatimeve mbi vlerën shtesë në krahasim me tatimet që paguhen nga të hyrat që i paguajnë si ndërmarrjet, ashtu edhe personat fizik, duke shkaktuar ndikësë negative mbi kursimet dhe investimet (në rastet ku tatimi mbi të hyrat ishte më i madh nga tatimi mbi vlerën shtesë).

Pas suficitit të realizuar në vitin 2000, Qeveria planifikonte të udhëheq politikë të buxhetit të barazpeshuar, por këto plane rranë poshtë për shkak të veprimeve luftarake në vitin 2001, që e cila rezultoi me deficit buxhetor prej 6,2%. Në periudhën e ardhshme u aplikua politika e konsolidimit fiskal, e posaçërisht në leminë e shpenzimeve publike, si dhe politika e ruajtjes së stabilitetit të çmimeve me çdo kusht.

Kjo politikë tejet restriktive fiskale kishte ndikësë negative mbi dinamikën e zhvillimit ekonomik.

## **Rekomandime**

Politika fiskale duhet të lëviz në drejtimet vijuese:

- zvogëlimi i shumës globale të rrogave në sektorin publik, parësisht përmes zvogëlimit të numrit të të punësuarve në shërbimet publike ( të identifikojë tepricën e personelit dhe realizimin e programit për reduktimin e tij);

- zvogëlimi selektiv i komponentave të shpenzimeve (kuantumi i output-shërbimeve, në raport me shpenzimet për output-të dalat)
- rishqyrtimi i programeve nga periudha paraprake në pajtim me zhvillimin ekonomik dhe ndryshimin e prioriteteve qeveritare, për shembull, revizioni i pagesave tek programet sociale, transferet kah ekonomia;
- ngushtimi dhe fokusimi i programeve sociale në drejtim të grupeve më të rrezikuara, kontrollime më të shpeshta për gjendjen e pasurisë dhe ndërlidhja me transferet sociale me programe të punëve publike;
- zëvendësimi i sistemit ekzistues pensional i ashtuquajtur “pass-as-you-go” me sistem të kombinuar pensional, i cili filloi të aplikohet kah fundi i këtij viti;
- rritja e zërit “transfere kapitale” në pozitën e Buxhetit, si komponentë e rëndësishme e rritjes afatgjate;
- reforma e ndërmarjeve publike e synuar në drejtim të zvogëlimit të nevojës për përkrahje nga shteti dhe harmonizimi me standardet evropiane;
- të analizohet legjislatura ekzistuese rreth tatimit personal mbi të ardhurat dhe të fillohet në mënyrë të shkallëzuar të aplikohet forma e pastër e tatimit personal i cili do të jetë në pajtim me tatimin personal të BE-së.

## **Ristruktuiimi, rivitalizimi dhe modernizimi i ekonomisë së Maqedonisë**

### **Përshkrimi i status kuosë**

Në periudhën e tranzicionit restruktuiimi i ekonomisë paraqet detyrë **prioritare** e politikës makroekonomike dhe zhvillimore. Kjo paraqet imperativin për zhvillimin e ekonomisë nacionale dhe për kyçjen më të suksesëshme të vendit në proceset integruese evropiane dhe botërore.<sup>1</sup>

Struktura ekzistuese në Republikën e Maqedonisë është e trashëguar nga sistemi paraprak shoqëroro-ekonomik në kuadër të konceptcionit për zhvillim të RSFJ-së së mëparshme. Në këtë kuadër ekonomia e Republikës së Maqedonisë ishte njëri prej furnizuesve me lëndë të para dhe materijale riprodhuese, ndërsa prodhimet finale ishin relativisht pak të përfshira në prodhimtarinë e tërësishme.

Privatizimi i paramenduar në mënyrë jopërkatese dhe i realizuar me sukses të pamjaftueshëm shkaktoi zvogëlimin e aktivitetit ekonomik dhe të bruto prodhimit vendas. Aktiviteti i ulët ekonomik dhe shpenzimi i ulët investues shkaktuan keqësimin e mëtejshëm të strukturës së ekonomisë nacionale. E tërë kjo kontribuoi që struktura e tanishme e ekonomisë të karakterizohet me përfaqësim të mjeteve themelore me shkallë të lartë të amortizimit, të mbizotërojnë teknologji të vjetëruara të proceseve prodhuese, orientim të pamjaftueshëm kah eksporti, varësi të lartë nga importi, me aftësi të ulët konkurruese, pjesëmarrje shumë të lartë të prodhimeve me faza të ulta të përpunimit dhe përfaqësim të ulët të prodhimeve sipas kërkesave dhe standardeve të tregjeve të huaja.

---

<sup>1</sup> Në materialin janë shfrytëzuar pjesë dhe konstatime nga libri “Ristruktuiimi prodhues i ekonomisë në Republikën e Maqedonisë”, redaktura e d-r Boris Bllazhevski, ZDOR, Shkup, 2002, faq. 11-35.

## **Përshkrimi i popullatës që është e influencuar/e goditur drejtpërdrejtë dhe si ajo është e influencuar/e goditur drejtpërdrejtë**

Republika e Maqedonisë ende nuk e ka arritur nivelin e prodhimtarisë së realizuar në vitin 1989. Kjo në masë të madhe është pasojë e strukturës së tanishme ekonomike. Në periudhën e tranzicionit u krijuan dukuri të reja sociale që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me aktivitetin të ulët të ekonomisë nacionale. Kjo manifestohet me shkallën e lartë të papunësisë, e shprehur përmes shfrytëzimit të ulët të fuqisë së re punuese në disponim, e posaçërisht të grave. Në periudhën e tranzicionit ballafaqohemi me paraqitjen e varfërisë dhe ekzistimin e një shtrese të gjërë të popullatës që është e varfër ose gjendet në kufirin e varfërisë,

Të dhënat zyrtare statistikore tregojnë se pjesa më e madhe e fuqisë së re të papunë janë persona nën moshën 25 vjeçare dhe se mes tyre gratë e përbëjnë pjesën më të madhe. Gjithashtu, është për tu shënuar se në grupin e të papunëve dhe të varfërve hyjnë personat me arsim të ulët dhe të mesëm dhe banorët në fshatrat të cilët të ardhurat i realizojnë nga aktivitetet bujqësore.

Tabela 1		
Karakteristika të punës	2002	2003*
Shkalla e të punësuarve (në %)	-	34,5
Shkalla e papunësisë (në %)	31,9	36,7
Burra	31,7	-
Gra	32,3	-
Nën moshën 25 vjeçare	58,4	-
Papunësia afatgjate (si pjesë e papunësisë së tërësishme)	84,5	-
Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punuese (në %)	52,6	54,5
Burra	63,7	-
Gra	41,5	-

Vërejtje: *papunësi afatgjate konsiderohet ajo mbi një vjet.* Të dhënat për grupet etnike janë për vitin 2000. Popullata e aftë për punë, të punësuarit dhe të papunët janë në pajtim me definicionin në maqedoni për moishën prej 15 deri 80 vjeçare.

- Të dhëna paraprake statistikore për vitin 2003, Enti i statistikës.

*Burimi: Anketa e fuqisë punuese, Enti i statistikës i RM*

Papunësia duhet të vëzhgohet edhe nga aspekti strukturor edhe nga aspekti etnik. Për shkak se, mes personave të papunë më e madhe është pjesëmarrja e popullatës rome (73,1% në vitin 2002). Mandej, vijon popullata shqiptare me pjesëmarrje mes të papunëve me 49,1%, popullata turke me pjesëmarrje mes të papunëve prej rreth 45% dhe popullata maqedonase me 28,2%. Posaçërisht është i madh numri i grave të papuna. Kështu, në vitin 2003, në popullatën aktive të grave, maqedonaset merrnin pjesë me 27,2%, shqiptaret me 5,7% dhe gratë nga popullata turke 4,3%. ndërsa popullata e grave rome, ka një pjesëmarrje modeste në këtë strukturë.

## **Analiza**

Orientimi themelor i ekonomisë së vendit është krijimi i kushteve dhe parasupozimeve për stabilizimin dhe përforcimin e sektorit real. Kjo mund të realizohet përmes procesit të përsheptuar të ristruktuimit të tij organizativ, kadrovik dhe teknik, rruajtjes dhe përforcimit të intenzitetit të rritjes së prodhimit dhe të shërbimeve. për këtë qëllim nevojitet **nxitja investimeve në përgjithësi, e posaçërisht të bizneseve të vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjeve private.**

Kjo do të kontribuojë për përsheptimin e procesit të ristruktuimit të, revitalizimit, modernizimit teknologjik dhe konsolidimin financiar të kapaciteteve ekzistuese dhe aplikimin e aktiviteteve të reja ekonomike.

Për përkrahjen e procesit të ristruktuimit të ekonomisë me rëndësi është **shfrytëzimi i plotë i potencialeve financiare vendase, si dhe i linjave kreditore nga bota e jashtme.** Është tejet me rëndësi që këto potenciale financiare të synohen në sferën prodhuese, e para së gjithash në programe investuese me orientim eksportues. Në këtë drejtim duhet të shfrytëzohen edhe mjetet e ndryshme që si donacione i merr vendi.

Mirëpo. shfrytëzimi më i plotë i mundësive nga marrëveshjet për tregëti të lirë e imponon intensifikimin e procesit të ristruktuimit të prodhimit në pajtim me kriteret dhe kërkesat e ekonomive të zhvilluara të tregut. Për **ristruktimin e ekonomisë është e nevojshme ngritja e nivelit teknologjik të proceseve prodhuese.** Me të drejtë theksohet se ristruktuimi i ekonomisë paraqet të vetmen

alternativë për kyçjen më të suksesëshme të ekonomisë së Republikës së Maqedonisë në rrjedhat botërore ekonomike.

Zhvillimi dhe ristruktuimi janë të kushtezuar nga gjendjet në ekonomi, kushtet e përgjithshme për ekonomizim, disponimi me faktorët prodhues dhe mobiliteti i tyre, rrethimi i jashtëm, si dhe nga efikasiteti i politikës makroekonomike dhe zhvillimore. E tërë kjo tregon **kompleksitetin e çështjeve të ndërlidhura me ristruktuimin prodhues së ekonomisë** në Republikën e Maqedonisë.

Struktura e këtillë **imponon investime relativisht të mëdha** me të cilat struktura do të modernizohet dhe do të rritet efikasiteti i ekonomisë së gjithmbarshme. Krahas ndryshimit të strukturës së ekonomisë, janë të nevojshme edhe investime edhe në **përmirësimin e menaxhmentit**.

Njëri nga shkaqet për rritjen e ulët të BPV (Bruto Prodhimit Vendas) dhe ristruktuimit të ngadalshëm të ekonomisë së Maqedonisë është mungesa e vullnetit për ndryshime. Rekomandimet tona kanë të bëjnë me grupet joformale të cilat qendrojnë prapa pushtetit dhe interesat e të cilave janë të ndërlidhura me garniturat pushtetmbajtëse pa marrë parasysh nga e cila parti është i përbërë pushteti. Këto grupe joformale janë themeluar në sistemin paraprak dhe të njejtat, me ndryshime të vogla, veprojnë në sistemin e ri demokratik-me orientim tregu i cili ndërtohet në Republikën e Maqedonisë. Duke druajtur mos vallë sistemi i ri ekonomik me orientim tregu dhe nga konkurenca që ai e imponon do të rrezikojnë interesat e tyre, këto struktura frenojnë ndryshimet. Për këtë shkak, ndryshimet e deritanishme në Republikën e Maqedonisë vlerësohen si të pamjaftueshme dhe si “kozmetike” duke mos ndryshuar marrëdhëniet në mënyrë qenësore. Kjo më së shumti ka të bëjë me transparencën dhe konkurrencën.

Konsiderojmë se realizimi më i shpejtë i ndryshimeve në të gjitha sferat e jetës shoqëro-ekonomike do të krijojnë kushte për ristruktuimin më të shpejtë të ekonomisë dhe për rritje më të shpejtë të BPV. Kjo do të thotë jo vetëm BPV më i lartë, por edhe punësim më i lartë, standard më i lartë i popullatës, por edhe profite më të larta të kompanive. Konkluzë e këtij konstatimi është se dobi më të madhe nga reformat dhe ristruktuimi i ekonomisë do të kenë shtresat e pasura të popullatës, dhe grupet joformale për të cilat u bë fjalë paraprakisht. Kjo do të thotë

se angazhimi ynë duhet të jetë në bindjen e këtyre grupeve se me zhvillimin e demokracisë dhe të konkurrencës ato nuk do të dëmtohen, por përkundrazi, të njëjtit do të jenë përfituesit më të medhenj.

## **Rekomandime**

*Si do të ndihmojë aplikimi i rekomandimeve tona për zgjidhjen e problemeve të theksuara në çështjen e parë.*

Rekomandimet kanë karakter të përgjithshëm dhe janë të njohura dhe shumë herë të elaboruara në opinion në Republikën e Maqedonisë. Janë organizuar tubime të shumta shkencore në të cilat janë trajtuar çështjet më të mëdha ekonomike me të cilat ballafaqohet Republika e Maqedonisë. **Problemet, por edhe drejtimet e veprimit, në masë më të madhe janë të sqaruara dhe të përcaktuara mirë.** Në Republikën e Maqedonisë ka përfunduar pjesa më e vogël e reformave, ndërsa pjesa më e madhe është në vazhde e sipër ose duhet të fillojë në një ardhmëri të afërt. Kjo imponon një **këmbëngulësi më të madhe në realizimin e reformave** në të gjitha lëmitë e shoqërisë.

**Ristruktimi i suksesëshëm i ekonomisë do të sjell edhe prodhim më të madh bruto në vend, shkallë më të lartë të punësimit dhe standard më të lartë jetësor të të gjitha shtresave të popullatës.** Ristruktimi i shpejtë dhe i suksesëshëm i ekonomisë është i lidhur ngushtë me shpejtësinë e rritjes së **efikasitetit të institucioneve, gjyqësisë dhe sjelljen e rregullativës së re** ose ndryshimin e asaj ekzistuese.

Me ndryshimin e strukturës së prodhimtarisë krijohen kushte për **shfrytëzimin më të plotë dhe aktivizimin e resurseve disponuese** të vendit. Kjo do të mundësojë dhe do të ndikojë edhe në shfrytëzimin më të madh të kapaciteteve ekzistuese prodhuese, për dinamizimin e eksportit, për prodhimin më të lartë bruto të vendit, e me këtë edhe për rritjen e shkallës së punësimit dhe të standardit jetësor të popullatës.

Për shtimin e prodhimtarisë, e në kuadër të kësaj edhe të eksportit, në një periudhë afatshkurtër por edhe në periudhë afatgjatë, pozitivisht do të veprojnë ndikesa e marreveshjeve për tregëti të lirë që Republika e Maqedonisë i ka nënshkruar me të gjitha ish-republikat jugosllave, me Bullgarinë, Turqinë, Ukrainën dhe Shqipërinë,

si dhe me vendet-anëtare të EFTA-së. Në të njëjtin drejtim ndikojnë edhe marrëdhëniet gjithnjë e më të afërta ekonomike dhe politike me Bashkimin Evropian, si dhe anëtarësimi i Maqedonisë në Organizatën Tregëtare Botërore.

- Në ndryshimet e strukturës ekonomike **detyrë parësore duhet të paraqet eksporti**. Tregu i Maqedonisë është i vogël dhe i ngushtë që ta pranojë tërë ofertën e ndërmarrjeve vendase. Deficiti i lartë që është në rritje e sipër është shkas plotësues për riorientimin e ekonomisë së Maqedonisë kah eksporti. Ministria e ekonomisë dhe Ministria e finansave janë kompetente për ristruktuimin e ekonomisë për eksport.
- Në kuadër të kësaj, aplikimi i diturive të reja dhe zhvillimi teknologjik paraqesin komponentë e rëndësishme për ristruktuimin e suksesëshëm të ekonomisë. Për realizimin e ndryshimeve në këtë lëmi është kompetente Ministria e ekonomisë.
- Krijimi i **klimes së volitshme dhe mundësimi i lehtësimeve për investitorët, si dhe për afaristët në përgjithësi** (për shembull, përmes lehtësimeve tatimore, doganore e tjera). Këto aktivitete **nuk kërkojnë shpenzime plotësuese nga buxheti**. Klima e volitshme investuese duhet të mundësojë edhe **shfrytëzimin më të plotë të burimeve finansiare vendase**. (Për shembull, bankat vendase rruajnë në bankat e jashtme shuma të mëdha kapitali në euro për çka marrin kamata të ulta, e njëkohësisht shfrytëzojnë kredi të jashtme me shkalla më të larta të kamatave). E njëjta vlen edhe për tërheqjen e investimeve të huaja. Investimet e jashtme do të kontribuojnë për hapjen më të shpejtë të ekonomisë, për rritjen e konkurrencës, si dhe për aplikimin e teknologjive të reja dhe të diturive menaxhuese dhe tjera. Këto parakushte të rëndësishme për ristruktuimin dhe modernizimin më të shpejtë të ekonomisë, në pjesë më të madhe, duhet të realizohet në kuadër të Ministrisë së finansave.
- Nevoitet përshpejtimi i procesit të **ristruktuimit të sektorit financiar, e në kuadër të tij edhe të bankave**. Përveç kësaj, nevojitet rritja e konkurrencës, në kuadër të kësaj edhe aplikimi më i madh i bankierizmit zhvillimor. Për realizimin e këtyre rekomandimeve janë kompetente Ministria e finansave dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

- Krijimi i **sistemit gjithëpërfshirës të përkrahjes së iniciativave sipërmarrëse** dhe krijimi i kushteve për përfundimin relativisht të shpejtë të procedurave lidhur me marrjen e dokumentacionit të duhur për fillimin e bizneseve të reja ose për zgjerimin e biznesit ekzistues. Ky rekomandim duhet të realizohet në kuadër të aktiviteteve të Ministrisë së ekonomisë.
  
- **Promovim i vazhdueshëm dhe sistematik i prodhimeve dhe i ekonomisë së Maqedonisë në botën e jashtme.** Kjo hyn në detyrat e Ministrisë së ekonomisë.
  
- **Inkorporimi, hap pas hapi, i ekonomisë së përhimtë në sektorin real.** Kjo duhet të bëhet përmes krijimit të kushteve për kyçjen spontane dhe vullnetare në sektorin real. Për këto aktivitete më së shumti kanë ingerenca Ministria e ekonomisë dhe Ministria e finansave.
  
- Për finansimin e rekomandimeve dhe masave lidhur me ristruktuimin të theksuara paraprakisht, mandej për revitalizimin dhe modernizimin e ekonomisë së Maqedonisë, **nuk ka nevojë për rritje të tatimeve dhe për ngarkesa të reja të njësisve ekonomike.** Në afat të shkurtër, mjetet e nevojshme për realizimin e rekomandimeve mund të sigurohen me rindarjen e mjeteve në kuadër të buxhetit, por, në periudha afatmesme dhe afatgjata duhet pritur **rritje të të hyrave buxhetore si rezultat i rritjes së prodhimit dhe të bruto prodhimit vendas.**

### *Realizimi i rekomandimeve*

Realizimi i rekomandimeve është në kompetencë të **Parlamentit dhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe të organeve të saja, agjensive dhe shërbimeve në të gjitha nivelet.** Në periudhën e deritanishme mungon politikë më e kordinuar dhe më e sinhronizuar në lëmin e ristruktuimit, investimit dhe politikës së punësimit. Nuk shfrytëzohen kapacitetet dhe dituritë intelektuale me të cilat vendi disponon. Shpesh herë, për zgjidhje banale, nevoitet shumë angazhim dhe kohë. Një numër i madh i agjensive nuk janë në nivelin e duhur sa u përket profesionalitetit dhe efikasitetit. Në kuadër të kësaj duhet të theksohet edhe **ekipimi i pamjaftueshëm me ekspertë i këtyre organeve dhe agjensive.** Rëndësi të veçantë kanë programet për kyçjen e grupeve me arsimim të ulët dhe të grave në proceset ekonomike në vend.

# **Zhvillimi i sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë**

## **Përshkrimi i status kuosë**

Politika ekonomike në Republikën e Maqedonisë (RM), siç është prezentuar në dokumentet zhvillimore qeveritare, e përcakton nevojën për zhvillimin të shpejtë dhe të papenguar të sektorit privat, por prapseprap, sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), ende nuk e ka fituar afirmimin dhe përkrahjen e duhur që duhet ta ketë dhe e cila është përditshmëri në vendet e zhvilluara, si dhe në vendet në tranzicion.

Sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, (pranë Ministrisë së ekonomisë) ka rëndësi të madhe për Republikën e Maqedonisë, për shkak se paraqet një sektor fleksibil, i aftë për krijimin e vendeve të reja të punës dhe jep dinamikë plotësuese për rritjen ekonomike. Për këtë qëllim, Qeveria në vitin 2002 e solli Strategjinë nacionale për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ndërsa në vitin 2003 solli edhe Programin për përkrahjen e sipërmarrësisë dhe për krijimin e konkurrencës së bizneseve të vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë.

Përkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme duhet të trajtohet si detyrë afatgjate në funksion të zhvillimit të qendrueshëm dhe në interes të afrimit më të shpejtë kah Unioni Evropian (EU). Prapseprap, edhe përkundër dokumenteve të miratuara zhvillimore që merren me zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), Qeveria nuk krijoi përkrahje dhe ndihmë përkatëse institucionale dhe finansiare, kështuqë nuk mund të thuhet se janë bërë ndryshime radikale në kuptim pozitiv në këtë lëmi. Intencat e Qeverisë më tepër mbetën deklarative dhe nuk sollën realizime konkrete, për shkak të disa faktorëve dominues: politike, institucionale, kadrovike, ekonomike dhe sociale.

Vetëm sa për ilustrim, në vend që firmave me humbje t'ju ofrohet ndihmë dhe të bëhet orientimi i tyre kah efikasiteti dhe profitabiliteti më i madh, vendimmarrësit në sferën ekonomike, ishin të preokupuar me zgjidhje jopërkatëse të problemeve të firmave me humbje. Gjatë fazës së parë të tranzicionit ekonomik Qeveria më në kohë duhej të ofronte stërvitje në lëminë e sipërmarrësisë dhe lëminë e punës afariste (vazhdimi i kualifikimit dhe rikualifikimi), të punëtorëve që potencijalisht janë të larguar nga puna, si dhe dhënia e drejtimit kuptimplotë për mjetet e pagesave që jepen gjatë largimit të tyre (për shembull: duke mundësuar që të merret me qira pajisja e ndërmarrjeve që punojnë me humbje, ose përmes obligimit të ndërmarrjeve të cilat punojnë mirë që një përqindje të caktuar të prokurimeve të tyre t'i kryejnë ndërmarrjet e vogla e kështu me rradhe). Kjo do të

siguronte përkrahje konkrete për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe punësime të reja, duke e zvogëluar në këtë mënyrë numrin e të papunëve.

Si rezultat i tranzicionit ekonomik, numri i ndërmarrjeve të reja, të vogla u shtua në mënyrë rapide, mirëpo numri i të punësuarëve në ndërmarrje të këtuja u zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme (215,8 në vitin 1989, 8,4 në vitin 1997 dhe 6,8 në vitin 2003), njëllonj si edhe numri i tërësishëm i të punësuarve në ekonominë e Maqedonisë.

*Tabela 1*  
**NUMRI I NDËRMARRJEVE AKTIVE DHE TË PUNËSUARIT**

Viti	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve
1989	2.003	432.400
1997	33.455	283.142
2003	39.199	262.728

*Burimi: sipas të dhënave të Entit për qarkullim pagesor*

*Tabela 2*  
**NUMRI I NDËRMARRJEVE AKTIVE NË VITIN 2001**

Ndërmarrje të vogla	34.113 (98,3%)	Të punësuar	119.565 (41%)
Të mesme	484 (1,4%)	Të punësuar	72.565 (24,8%)
Të mëdha	119 (0,3%)	Të punësuar	100.526 (34,2%)
Gjithsej	34.716 (100%)	Të punësuar	292.526 (100%)

*Burimi: regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë*

*Tabela 3*  
**NUMRI I NDËRMARRJEVE AKTIVE NË VITIN 2003**

	Ndërmarrje	%	Të punësuar	%
Ndërmarr. të vogla	35.858	98,3	122.046	44
Të mesme e të mëdha	608	1,7	155.214	56
Gjithsej	36.466	100	277.260	100

*Burimi: Regjistri qendror*

*Tabela 4*  
*NUMRI I NDËRMARRJEVE AKTIVE NË VITIN 2003*

	Ndërmarrje	%	Të punësuar	%
Ndërm. të vogla	38.581	98,5	110.373	42
Të mesme dhe të mëdha	618	1,5	152.355	58
Gjithsej	39.199	100	262.728	100

*Burimi: Regjistri qendror*

### **Përshkrimi i popullatës së involvuar**

Politika qeveritare në lëmin e NVM, involvon të gjitha sipërmarrësit dhe afaristët potencial në përgjithësi. Mirëpo, shumë pak prej tyre kanë qasje deri tek kreditë, posaçërisht ata nga mjediset rurale dhe bujqësore, mandej ata nga qytetet më të vogla si dhe njerëzit nga shtresat më të varfëra dhe pjesëtarët e pakicave, (posaçërisht Romët). Këto grupe nuk kanë mjete të mjaftueshme që të sigurojnë garancione për të marrë kredi. Për shkak të arsimimit të tyre të ulët, si dhe për shkak të mungesës së kualifikimeve dhe diturive profesionale, gjasat e tyre që të punësohen në ndërmarrje tjera janë të vogla. Në vendet më të vogla nuk ka institucione, ndërsa më të mëdhatë nuk janë efikase aq sa duhet, të cilat do t'ju ndihmonin sipërmarrësve potencial me: këshilla, konsultime, informacione, si dhe me hua dhe kredi të caktuara që janë të volitshme. Të gjitha institucionet për përkrahjen e NVM, gjenden në qendrat më të mëdha në Maqedoni. Gjatë kësaj, shfrytëzuesit potencial të shërbimeve të tyre nuk janë të informuar në mënyrë të mjaftueshme, kështuqë veprimi i këtyre institucioneve/qendrave/fondacioneve/programeve/bankave/kursimoreve nuk e përfshijnë shumicën.

Grupet më të prekura ose më të goditura janë:

- të varfërit nga mjediset qytetare dhe fshatare;
- të paarsimuarit;
- minoritetet (posaçërisht ai Rom);
- fshatarët dhe njerëzit nga mjediset fshatare;
- gratë nga të gjitha kategoritë e përmendura më lartë;
- të rinjtë

## **Analiza**

Në këtë pjesë do t'i shqyrtojmë katër pengesat kryesore për zhvillimin e shpejtë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe do të propozojmë mënyra përmes të cilave do të përparohen kapacitetet lokale.

### *Pengesa për zhvillimin e NVM*

#### **(a) Kushte të pavoritshme bankare**

Bankat nuk ofrojnë qasje të mjaftueshme për sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ekziston një mungesë e qasjes relativisht të lehtë ndaj kapitalit fillestar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, gjë e cila ndodh për shkak të kriterëve të ashpra bankare për sigurimin e mjeteve, e posaçërisht për shkak të kërkesës për garanci të larta (hipoteka të cilat janë edhe deri tri herë më të larta sesa shuma e kredive), si dhe shkallët e larta të kamatave (15-20%). Bankat poashtu kërkojnë të dhëna të detajuara për punën paraprake afariste.

Banka Maqedonase për përkrahje të zhvillimit, si bankë shtetërore, përkrah eksportin, mirëpo nevojiten aktivitete të mëdha në lëmin e sigurimit për qasje më të lehtë për kreditë të dedikuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për sipërmarrësit potencial.

Nuk ekziston rregullativë ligjore që ka të bëjë vetëm me sektorin e NVM, si dhe ligj për të ndihmuar NVM-të, ose për aktivitete tjera siç janë lehtësime dhe lirime nga obligimet tatimore dhe doganore.

Gjendja e vështirë e përgjithshme ekonomike (kriza politike, rrethimi jostabil afarist, gjyqësia joefikase) përforcon pengesat e këtilla serioze duke penguar shfrytëzimin e linjave kreditore që janë në dispozicion.

Janë të nevojshme institucione dhe mekanizma jobankare për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Nuk ekzistojnë fonde për aktivitetet fillestare afariste, fonde për garancione dhe investime të rrezikshme (përveç dy fondeve që janë të finansuara nga donatorët), posaçërisht fonde në nivel lokal, ose instrumente të tjera (programe për krijimin e ndërmarrjeve të reja për kuadro të reja dhe të arsimuara, gra-sipërmarrëse potencijale, sipërmarrës nga rajonet rurale e kështu me radhë).

#### **(b) Mungesë e kornizës së volitshme ligjore**

Nuk ekziston rregullativë ligjore që ka të bëjë vetëm me sektorin e NVM, si ligj për të ndihmuar NVM-të, ose për aktivitetet tjera siç janë lehtësime dhe lirime tatimore dhe doganore

Mungojnë çfardoqoftë lehtësimesh (doganore, tatimore) posaçërisht për ata që janë fillestarë në lëmin e afarizmit, ose së paku për vitet e para e punës afariste. Përrjashtim nga kjo rregull ishte i ashtuquajtur i "Ligj i Brankos", i cili u mundësoi punëdhënësve të mos paguajnë kontributet që paguhen për rrogat e të punësuarve të ri. Si rezultat i këtij Ligji, herën e parë, në vitin 1997/98 u punësuan 80.000, ndërsa herën e dytë, në vitin 2003 rreth 15.000 persona. Ky Ligj u shfrytëzua edhe nga ata që fillonin në lëmin e afarizmit.

### **(c) Mosekzistimi i qasjes gjithpërfshirëse dhe të koordinuar mirë**

Të gjitha vendimeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e NVM, duke përfshirë edhe Programin e masave dhe të aktiviteteve për përkrahjen e sipërmarrësisë dhe për krijimin e konkurrencës së bizneseve të vogla dhe të mesme në RM, u mungon qasje selektive për ndihmesën dhe përkrahjen e NVM-ve. Kjo qasje është e rëndësishme për t'ju përgjegjur nevojave të ndryshme të ndërmarrjeve të reja dhe të posaformuara në raport me ndërmarrjet e mesme, stabile dhe që kanë zhvillim të hovshëm.

**Mungon vazhdimësia** në realizimin e masave dhe aktiviteteve të përcaktuara që shërbejnë për tu ndihmuar NVM-ve.

### **(d) Mungesa e përkrahjes institucionale**

Nuk ekziston numër i mjaftueshëm i institucioneve efikase që do tu sigurojnë sipërmarrësve përkrahje profesionale në të gjitha lëmitë e punës, si për shembull: këshilla, informacione afariste, stërvitje permanente, ndihmë për realizimin e eksportit dhe rritja e cilësisë përmes teknologjive të reja.

Njëra nga pengesat është mosaplikimi i procedurës administrative nga ana e atyre që kanë të drejtë diskrecionale ta bëjnë këtë.

Pengesat tjera serioze kanë karakter burokratik. Këto janë: gjyqësia joefikase, procedura të ndërlikuara dhe të ngadalshme për marrjen e lejeve urbanistike, të lejeve ndërtimore dhe për transferin e të drejtave pronësore nga komunat, si dhe sistemi i vjetëruar i kadastrës. Përkundër përpjekjeve deklarative të Qeverisë për thjeshtësimin e procedurave të regjistrimit (duke e përfshirë edhe aplikimin e sistemit *të një sporteli*) dhe për krijimin e ambientit të volitshëm afarist në lëmin e ekonomisë, deri tani asgjë nuk është bërë.

#### *Përforcimi i kapaciteteve ekzistuese*

Infrastruktura ekzistuese institucionale që ka të bëjë me inkubatorë afarist, fondacione, agjensi, fonde garantuese, programe për mikrofinansim e tjera, në

pjesën më të madhe mbështetet në mjete nga donatorët. Për tu konfirmuar përkrahja deklarative për ndërmarjet e vogla dhe të mesme, Qeveria e Maqedonisë padyshim duhet ta rrisë rolin e saj në ndihmën dhe përforcimin e infrastrukturës afariste.

Përforcimi i sipërmarrësisë dhe i sektorit të NVM është i mundshëm vetëm me përkrahjen përkatëse financiare (institucione dhe instrumente financiare). Duhet të sigurohen lloje të ndryshme të ndihmës, varësisht nga fazat e zhvillimit të një ndërmarje të vogël ose të mesme. Në pajtim me këtë, nevojat për mjete janë vijueset:

1. Kapitali filestar për finansimin e aktiviteteve nisëse të sipërmarrësve,
2. Kapital qarkullues për ndërmarjet ekzistuese të vogla dhe të mesme,
3. Kapital investues për zhvillimin plotësues, eksportin dhe aplikimin e teknologjive të reja.

Ekziston një mendim gjërësisht i përkrahur se vetëm sistemi bankar, përkatësisht vetëm bankat komerciale janë burimi i finansimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ky mendim injoron nevojën dhe rolin e institucioneve jobankare dhe instrumenteve tjera për finansimin e sipërmarrësisë. Kështu, agonia e sipërmarrësve potencial vazhdon, për shkak se nuk mund të përmbushin kushtet e ashpra, madje të pamundshme bankare për marrjen e kredisë. Thjeshtë, kreditë nuk janë të kapshme për fillestarët në biznes, pa marrë parasysh nëse ata janë bujq, afaristë të vegjël ose sipërmarrës potencial.

Kjo qasje rrezikon zhvillimin e klimës së volitshme për investime. Disa qasje alternative shfaqin edhe shembujt pozitiv: për shembull puna e kursimore “Mozhnosti”, kooperativat kursimore-kredituese FULM, programi “Horizontet për gratë sipërmarrëse” SEAF/Maqedonia. Nga ana tjetër, praktika tregon se vetëm 60% deri 80% nga linjat e miratuara kreditore që realizohen përmes sistemit bankar janë me të vërtetë të realizuara gjatë periudhës së kaluar. Kjo thekson nevojën për përshtatjen e shpejtë dhe efikase të sistemit bankar kah nevojat e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme dhe kah nevojat e sipërmarrësve.

## **Rekomandime**

### ***(a) Kushte të volitshme bankare***

Zhvillimi i llojeve të qendrueshme të përkrahjes financiare të ndërmarjeve të vogla përmes:

1. Huave të volitshme për fillimin e kryerjes së veprimtarisë, përkatësisht “start up” aktiviteteve afariste të ndërmarjeve;
2. Ndërlidhja e iniciativës publike me ato private dhe shtimi i investimeve në ndërmarjet/bizneset/tregëtarët e vegjël;
3. Garancione të volitshme për ndërmarjet dhe aktivitetet e vogla të ndërmarjeve/bizneseve/tregëtarëve/afaristëve të ri;
4. Themelimi i: fondeve kredituese-garantuese, fondeve investuese të kapitalit të rrezikshëm, fondeve investuese për kapital fillestar, fondeve për përkrahjen e eksportit, fondeve për transfer teknologjik, fondeve për standardizimin e cilësisë e kështu me radhë;
5. Rritja e pjesëmarrjes së investimeve të rrezikshme në sektorin e ndërmarjeve/aktiviteteve afariste të vogla.
6. Klasifikimi i ri i aktiviteteve afariste (bizneseve) sipas madhësisë së tyre (sipas numrit të të punësuarve dhe të ardhurave vjetore) që posaçërisht është e rëndësishme për të përcaktuar cilët shfrytëzues do të mund të shfrytëzojnë përkrahje të caktuar financiare, përkatësisht, riorganizimi i përcjelljes zyrtare të sektorit të NVM në statistikën zyrtare të RM-së;
7. Të miratohet program afatmesëm zhvillimor (me masa, instrumente, indikatorë) për përdorimin e fondeve publike (vendase dhe ndërkombëtare);
8. Krijimi i kushteve të volitshme për rritjen e ndërmarjeve të reja, si dhe për rritjen e numrit të vendeve të punës;
9. Rritja e mundësive për aplikimin e potencialeve inovative (qendra për përkrahje konsultante dhe financiare gjatë regjistrimit të patenteve, liçencave në vend dhe në BE e kështu me radhë);

10. Krijimi i sistemit efikas për përkrahjen e NVM në të gjitha fazat zhvillimore të ekzistimit të tyre, përmes sigurimit të qasjes deri te informacionet, shërbimet dhe përkrahja financiare në mbarë vendin;
11. Të stimulohet bashkëpunimi dhe lidhja e subjekteve të vogla dhe të reja afariste (përmes parashikimit të prioriteteve për dhënien e përkrahjes financiare nga fondet publike për zona/kllasterë industrial, rrjete teknologjike, konzorciume eksportuese e ngjashëm) në pajtim me programet ndërkombëtare të përkrahjes;
12. Financimi stabil i inovatorëve përmes zhvillimit të inkubatorëve afaristë, qendrave teknologjike dhe parqeve, qendrave inovuese, qendrave hulumtuese-zhvillimore;
13. Promovimi dhe përkrahja e orientimit eksportues dhe internacionalizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

***(b) Kornizë e volitshme juridike***

Patjetër duhet të miratohet dhe të aplikohet rregullativa përkatëse ligjore në lidhje me sektorin e NVM, përmes harmonizimit të aktiviteteve në ministritë e caktuara, konzistencës dhe harmonizimit të zgjidhjeve ligjore në ligje të ndryshme: si për shembull në Ligji për shoqëritë tregëtare të përmbajë pjesë të veçantë për tregëtarët/ndërmarrjet e vogla, si dhe Ligji për pagesa fiskale, pagesa doganore në sajë të bazave të ndryshme dhe kontabiliteti.

***(c) Qasje gjithpërfshirëse dhe e koordinuar mirë***

Përgatitja e politikave përkatëse konzistente dhe të sinhronizuara për zhvillimin e NVM. Këto politika duhet të aplikohen përmes programeve të përbashkëta në nivel nacional dhe lokal (duke përfshirë edhe atë që programet vendase dhe të jashtme ti përkrahin qëllimet e njejta në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme).

Të gjitha procedurat në administratën shtetërore duhet të thjeshtësohen dhe të bëhen më transparente dhe të jenë të definuara mirë (për tu zvogëliar mundësitë për vendime arbitrare).

#### ***(d) Përmirësimi i kapaciteteve institucionale***

Duhet të zhvillohet **infrastruktura përkatëse institucionale** e harmonizuar me strukturat e UE-së, përmes themelimit të institucioneve/agjensive/fondacioneve qendrave/fondeve: për garancione, për rreziqe e ngjashëm, zona inkubatorë/industrialo-sipërmarëse e kështu me radhë.

Gjithashtu në mbarë vendin duhet të zhvillohet infrastruktura institucionale e:

- a) sistemit një-sportel,
- b) qendrave informativo-konsultuese,
- c) qendrave për përkrahje financiare,
- d) qendrave për arsimim të vazhdueshëm të sipërmarrësve (në lëmitë siç është menaxhmenti, marketingu, revizioni i brendshëm, eksporti e kështu me radhë),
- e) qendrave bankare për disa dedikime për kredi të “buta”,
- f) qendrave për regjistrimin, promovimin dhe komercijalizimin e inovacioneve,
- g) qendrave për aplikimin e standardeve për cilësi dhe transfer të teknologjive,
- h) internacionalizimin e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme.

#### ***Ndikesa***

Aplikimi i këtyre rekomandimeve do të mundësojë biznes klimë të volitshme: sistem institucional transparent, të parashikueshëm (sëpaku në periudhë afatmesme), stabil, efikas dhe të konsoliduar, politikë konzistente, forma të sinhronizuara dhe të llojllojshme politike e të përkrahjes financiare. Ky lloj i klimës do të mundësojë parakushte për zhvillimin e sektorit të ndërmarjeve të vogla dhe të mesme dhe në këtë mënyrë do të mundësojë hapjen e vendeve të reja punuese dhe vetëpunësimin të sipërmarrësve pa dallim të gjinisë, moshës, statusit social, besimit fetar ose të arsimimit.

Zhvillimi dhe përparimi i konkurrencës së ndërmarjeve të vogla dhe të mesme do ta përforcojë tregun, si dhe shërbimet konsultative, stërvitjen e sipërmarrësve, përkrahjen inicuese për fillimin e bizneseve të reja (Start ap), ose transferin e teknologjive, si dhe ndërkombëtarizimin e bizneseve të vogla, aplikimin e standardeve për cilësinë dhe orientimin kah eksporti e kështu me radhë.

## **Zbatimi**

Rekomandimet duhet ti zbatojnë: **Qeveria** dhe institucionet kompetente – **ministrinë** – Ministria e ekonomisë, Ministria e finansave, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e bujqësisë dhe e pylltarisë, Ministria e transportit dhe e lidhjeve, komunat, si dhe **institucionet/odat, shoqatat/fondacionet rajonale për zhvillimin e NVM/agjensitë e ndërmarrjeve qendrat e zhvillimit lokal e tjera relevante, si dhe Agjensia për përkrahjen e sipërmarrësisë në RM**, përkatësisht në nivel nacional dhe lokal në kordinim (program unik, i përbashkët zhvillimor për NVM) me programet ndërkombëtare për përkrahje (USAID, UNDP, FARE, KARDS, programet për ndihmë teknike të qeverive të Holandës, Gjermanisë Austrisë, Zvicrës, Japonisë, Italisë, Francës e kështu me radhë).

## **Stërvitja dhe edukimi afarist**

### **Përshkrimi i status kuosë**

Stërvitja dhe metodat tjera të edukimit për menaxhment të suksesëshëm afarist në Republikën e Maqedonisë filluan në vitet e hershme të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar me seminare dhe kurse për menaxhment afarist, fillimisht përmes studimeve për Magjistër në administratën afariste (MAA) të Institutit për hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike (IHSPJ) të përkrahura nga Programi Tempus. Kjo u përcoll me aplikimin e studimeve të posaçme postdiplomike të menaxhmentit (në Fakultetin e Ekonomisë në Shkup) dhe lëndë të caktuara në fakultete të shumta në Univerzitetet në Republikën e Maqedonisë.

Fakulteti i Ekonomisë në Univerzitetin në Shkup dhe Univerziteti i Evropës Juglindore (UEJL) në Tetovë ofrojnë programe deri në diplomim për administratë afariste. Gjithashtu, ekzistojnë disa programe të specializuara për menxhment. Për shembull, në Prilep ekziston një seksioni për marketing, në Shkup në fakultetin e Makinerisë ekziston programi për inxhinieri dhe menaxhment industrial, në Ohër ka lëndë nga lëmia e menaxhmentit në turizëm dhe katering. Në nivel-postdiplomik ekziston MAA në Fakultetin e Ekonomisë në Shkup dhe në Fakultetin në Prilep. Gjithashtu, ekziston lëmi e veçantë e koncentrimit në menaxhmentin (menaxhmenti i resurseve njerëzore në IHSPJ) dhe menaxhmenti ndërkombëtar dhe menaxhmenti i biznesit të vogël (në Institutin Ekonomik në Shkup). Poashtu ekzistojnë edhe lëndë për menaxhmentin e cilësisë së tërësishme në Fakultetin Teknologjiko-Metalurgjik në Shkup.

Dy problemet kryesore me këto kurse janë si vijon:

- (1) Titujt e programeve dhe lëndëve nuk e reflektojnë materien e përfshirë në to; përmbajtja nuk i merr parasysh teorinë dhe praktikën e menaxhmentit bashkëkohor;
- (2) Profesorët i kushtojnë theks tejet të madh e të panevojshëm teorisë në llogari të shkathtësive praktike dhe përdorin metoda të vjetëruara të ligjerimit që nuk arrijnë të krijojnë ambient interaktiv të përshtatshëm për mësim.

Nëse çështjen e cilësisë e lëmë anësh, këto menaxhment programe kanë ndikësë të kufizuar në numrin relativisht të vogël të studentëve të regjistruar (vlerësohet se ka 500 studentë në studimet deri në diplomim dhe 100 studentë në studimet postdiplomike).

E vetmja mundësi tjetër për ata që janë të interesuar për menaxhment është të shkojnë jashtë (disa donatorë ofrojnë bursa që këtë t'ua mundësojnë studentëve) ose të vijojnë studimet në segmentit të posaformuar në Shkup të shkollës për politikë publike dhe menaxhment të Univerzitetit të Pitsburgut. Edhe pse kjo shkollë ofron nivel të lartë të mësimi, regjistrimi është tejet i kufizuar.

Deri tani kishte tre lloje të programeve për stërvitje afariste të mbshtetura në nevojat e ndryshme të studentëve, të punësuarve individual dhe institucioneve dhe kompanive shtetërore.

- Stërvitje plotësuese për studentë të regjistruar në studimet deri në diplomim dhe studimet postdiplomike;
- Stërvitje në shkallë primare për kompani të caktuara në tranzicion dhe për menaxherë të veçantë të kompanive të ndryshme që përshijnë seminare dhe kurse për zhvillimin e shkathtësive të caktuara menaxhere, diturive të specializuara dhe promovimin afarist (marketingun); disa prej këtyre stërvitjeve mbahen në botën e jashtme dhe janë të përkrahura nga donatorë të ndryshëm të jashtëm.
- Stërvitja për shpërndarje të informacioneve dhe menaxhmentit të biznesit të vogël, të paramenduara, të implementuara dhe të përkrahura financiarisht drejtpëdrejtë nga shteti (NEPA, SEED, Ministria e ekonomisë e kështu me radhë), e ndonjëherë tërthorazi nga donatorë të huajë.

## **Përshkrimi i target popullatës**

Raportet tjera, të paraqitura në pajtim me këtë raport e përshkruajnë rrethimin makroekonomik ([shih raportet për Politikën Fiskale, kursin dhe politikën monetare](#)) dhe sfidat me të cilat ballafaqohen bizneset e vogla. Besojmë se suksesi më i madh i stërvitjeve dhe edukimit afarist do tu ndihmojë studentëve, sipërmarrësve dhe menaxherëve nga sektori publik dhe privat që ti tejkalojnë këto sfida.

Ekziston mungesa e të dhënave të sakta për numrin e personave që do të kishin përfitime nga stërvitjet afariste. Prapsepap, stërvitjet do të duhet (do të mund) tu ofrohen grupeve vijuese:

- Njerëzve të rinj në studimet e rregullta deri në diplomim;
- Njerëzve të rinj, e posaçërisht grave, që dëshirojnë ti përmirësojnë dituritë për biznesin (seminare, studime pas-diplomike e kështu me radhë);
- Themeluesve të kompanive me kapital të huaj;
- Sipërmarrësve që do të dëshironin të themelojnë biznese të reja;
- Atyre në sektorin joformal (ekonominë e përhimtë) që do të ishin të aftë të transformohen në mikro-ndërmarrje;
- Menaxherëve në sektorin publik (ndërmarrjet komunale dhe publike).

## **Analiza**

Ministria e ekonomisë para do kohësh miratoi strategji për zhvillimin e bizneseve të vogla. Njëri nga komponentat e kësaj strategjie ishte që të kyçen më tepër stërvitje. Prapsepap, sfida është që të gjendet përkrahje e cila është më tepër se deklarative. Ministria e ekonomisë nuk ka kycje të drejtpërdrejtë formale në edukimin. Gjithashtu, kjo ka nevojë nga ndihma më e madhe në zhvillimin dhe implementimin për ndërmarrje të vogla dhe të mesme ([shih raportin e MSP](#)).

Ministria e arsimit, nga ana tjetër, është e angazhuar me funksionimin e institucioneve ekzistuese ([shih raportet dhe rekomandimet për arsimin](#)), e jo me zhvillimin e programeve të reja.

Institucionet ekzistuese arsimore shfaqën sjellje monopoliste edhe në hapjen në teren shohin si në konkurrencë të padëshiruar.

Këshilli i akreditimit, i cili sjell vendime për propozimet për lëndë të reja në sektorin formal arsimor dhe i cili është nën dominimin e personave nga fakultetet në Shkup dhe në Manastir, patjetër duhet ta zgjerojë anëtarësinë e tyre, duke përfshirë ministrinë e ekonomisë, Odën ekonomike e kështu me radhë.

Diskutimet për ndryshimet e Ligjit për arsim, që ishin të inicuar nga përpjekjet për njohjen e universitetit të tretë shtetëror, hapën mundësinë që faktorët e interesuar ti shqyrtojnë përbërjet, politikat dhe vendimet e këshillit të akreditimit.

## **Rekomandimet**

Rekomandimet tona janë të pavarura njëri nga tjetri. I pari, për reformimin e këshillit të akreditimit, do të mundësonte hapjen e programeve të reja në studimet në arsimin e lartë përmes zhvillimit të institucioneve vendase dhe përmes tërheqjes së degëve të reja të univerziteteve nga bota e jashtme. Grupi i dytë i rekomandimeve fokusohet në zhvillimin e diturive dhe të praktikës për menaxhmentin e studentëve, sipërmarrësve në sektorin privat dhe menaxherët nga sektori publik.

### *1. Reforma e këshillit të akreditimit*

Anëtarësimi në Këshillin e akreditimit është dominues vetëm për dy faktorë të interesuar – univerzitetet shtetërore dhe qeverinë. Për të siguruar klimë më të mirë për konkurrencë mes institucioneve të arsimit të lartë, propozojmë ristruktuimin e Këshillit të akreditimit për ta mundësuar kyçjen e përfaqësuesve të kolexheve dhe univerziteteve private edhe nga dy faktorë të tjerë të interesuar kryesor: odat ekonomike, Ministria e ekonomisë e kështu me radhë. Kjo do ta zgjëronte dhe përmirësonte cilësinë e diskutimeve, do tu ofronte më shumë mundësi konsumatorëve të arsimit që ti shfaqin qëndrimet e tyre dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësinë për vendimet e miratuara nga Këshilli i akreditimit.

### *3. Stërvitja*

Mënyra më e mirë për përmirësimin e ekonomisë mund të arrihet përmes katër kategorive vijuese të stërvitjes afariste:

- a) Kyçja e ideve për zhvillimin e frymës së sipërmarrësisë në programet për arsim fillor dhe të mesëm;
- b) Menaxhment programet të studimeve deri në diplomim;
- c) Studime të magistraturës për menaxhment afarist; dhe
- d) Programe modulare për stërvitje për biznese të vogla.

(a) Tanimë kemi përvoja të caktuara dhe iniciativa të reja për përfshirjen e përmbajtjeve nga lëmia e biznesit dhe menaxhmentit në arsimin fillor dhe të mesëm, por kemi nevojë për stërvitjen e personelit që do ta realizojë mësimin. Nevoitet të sigurohet stërvitje e veçantë për trajnerët që do të kyçen në implementimin.

(b) Menaxhment programet e studimeve deri te diplomimi janë aplikuar, por besojmë se nuk kanë cilësi të mjaftueshme në përmbajtjet dhe mësimin. Hapja e studimeve të menaxhmentit deri në diplomim përmes disa shkollave të menaxhmentit nga ShBA, ose me përkrahjen e tyre, në mënyrë të konsiderueshme do ta shtonte cilësinë dhe konkurrencën në këtë lëmi. Kur të ndodh kjo, do të paraqitet nevoja e vërtetë për modernizimin e programeve ekzistuese dhe të trajnimit plotësues për më shumë profesorë.

(c) Për studime për specializim dhe magjistraturë, duhet të jepet përkrahje për përmirësimin e kapaciteteve lokale për vendosjen e fondeve të posaçme për bursa dhe për mundësitë për kreditimin e personave të papunë dhe të të punësuarve. Këto fonde do të mund të sugurohen nga donatorët ekzistues për zhvillim, si dhe nga odat e reja ekonomike që janë në procedurë të themelimit. Këto duhet të jenë mekanizma përmes të cilave menaxherët e ri do të mund të marrin stërvitjen plotësuese për udhëheqjen dhe zgjerimin e punës së kompanive private.

(d) kategorija e fundit, stërvitjet, duhet të fokusohen në zhvillimin e programeve për stërvitjeve për mësim të sipërmarësisë dhe të biznesit deri në fund të jetës. Strategjisë për përmirësimin e sipërmarësisë të Ministrisë së ekonomisë duhet ti jepet përkrahje në formë të përmirësimit të menaxhmentit dhe të konkurrencës së lëndëve Më poshtë janë dhënë tre shembuj të moduleve (programeve për stërvitje), që do ta mundësonin diturinë dhe shkathhtësinë e nevojshme:

#### 1) Hyrje në sipërmarësinë (Moduli i sipërmarësisë)

ME - 1. Sipërmarësia dhe biznesi i vogël

ME – 2. Planifikim afarist

ME – 3. Franshiza

ME – 4. Themelimi i mikro-bizneseve dhe të liderizmit

#### 2) Menaxhmenti i ndërmarjeve të vogla (Modul për ndërmarje të vogla):

MSB – 1. Menaxhment personal (si të bëhesh pronar dhe menaxher i suksesëshëm)

MSB – 2. Marketingu

MSB – 3. Menaxhmenti financiar

MSB – 4. Menaxhmenti i resurseve njerëzore

MSB – 5 Menaxhment operativ

MSB – 6. Menaxhimi me cilësinë

MSB – 7. Menaxhmenti ekipor

MSB – 8. Menaxhmente të ndryshme organizative

MSB – 9. Komunikim afarist

3) Stërvitje për ndihmë në tranzicionin prej ndërmarjes së vogël në të mesme (modul për ndërmarje të mesme)

MMB – 1. Delegimi dhe puna ekipore

MMB – 2. Ndryshime organizative

MMB – 3. Vlerësimi dhe evaluimi (Menaxhment i zbatimit)

MMB – 4. Menaxhment i sistemeve informative

MMB – 6. Sistemi i rrogave dhe i beneficioneve

MMB – 7. Menaxhment i projekteve

MMB – 8. Marketing

MMB – 9. Menaxhment financiar

## **Lista e pjesëmarrësve në grupin punues për ekonomi**

- z-ti Fatmir Besimi – *vice guvernator, Banka Popullore*
- z-ti Goce Bozhnovski – *përfaqësues nga Qendra Informativ Turistike*
- z-nja Emanuella Efremovska – *postdiplomante në ekonominë monetare*
- z-ti Besnik Fetai – *profesor i ekonomisë (ish ministër i ekonomisë)*
- z-ti Ruzhdi Ibrahimov – *jurist, Ministria e ekonomisë*
- d-r. Tihomir Jovanovski – *profesor në pension dhe redaktor përgjegjës i revistës “Biznes dhe ekonomi”*
- z-ti Goran Kormushovski – *menaxher i shitjes në Fuks Mak*
- d-r. Todor Kraleov – *profesor, Fakulteti i makinerisë, Shkup*
- d-r. Bllagoja Nanevski – *profesor, Instituti i ekonomisë Shkup*
- z-ti Dejan Pendev – *këshilltar, Instituti i ekonomisë Shkup*
- z-ti Stefan Pepovski – *sektori për kartela kreditore, Stopanska banka( Banka ekonomike) Shkup*
- d-r. Cvetko Smilevski – *profesor në Fakultetin e menaxhmentit në Manastir dhe kryetar i DETRA qendrës*
- d-r. Vesna Sojanova – *profesor, Instituti i ekonomisë Shkup*
- d-r. Marija Zarezankova Potevska – *udhëheqëse e sektorit për sipërmarrësi, Ministria e ekonomisë*